



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA \\
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:190669
Datë: 27.11.2024
Numri i dokumentit: 06520743

C.nr.1806/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses – kundërpaditurës D.K. , me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Xh.K. , kundër të paditurit – kundërpaditësit I.D. i përfaqësuar sipas autorizimit nga A.D., avokat nga Mitrovica, dhe të paditurve Xh.L. dhe L.H. i përfaqësuar sipas autorizimit nga A.F., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti: kompensim dëmi, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit kryesor publik në prani të autorizuarit të paditëses - kundërpaditurës, të paditurit – kundërpaditësit së bashku me të autorizuarin e tij, në mungesë të paditurit Xh.L., e në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurit L.H., me datë 27.11.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses – të kundërpaditurës D.K. me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit I.D. me vendbanim në Rr. “D.22” në Mitrovicë, Xh.L. me vendbanim në Rr. “S.V.” në Fushë Kosovë dhe L.H. me vendbanim në lagjen “B.D.” në Prishtinë, që në emër të dëmit të shkaktuar D.K., t’ia paguajnë shumën në vlerë prej 3,318.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën përmbarimi do të bëhet me detyrim.

II. APROVOHET në tërësi e bazuar kundërpadia e të paditurit – kundërpaditësit I.D. nga Mitrovica dhe **DETYROHET** paditësja e kundërpaditura D.K. që në emër të kompensimit për automjetet e konfiskuara pa bazë ligjore kombi Mercedes Benz sprinter me targa të regjistrimit TCC 680, Mercedes Benz vito 115 CDI 2.9t me targa të regjistrimi DAA 622 dhe automjeti Volkswagen Caddy skabil 1.9 TDI me targa të regjistrimit OMO 247, t’ia paguaj shumën prej 15,812.72 euro dhe në emër të mallit të konfiskuar pa bazë ligjore t’ia paguaj shumën prej 11,054,90 euro, e në shumën e përgjithshme prej 26,867.62 euro (njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e dy cent), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga marrja e aktgjykimit me datë 27.11.2024 e deri në përmbushjen e tërësishme, në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm ligjor.

III. Detyrohet paditësja e kundërpaditura D.K. që në emër të shpenzimeve procedurale të paditurit - kundërpaditësit I.D. t’ia paguaj shumën prej 1,439.60 euro dhe të paditurit L.H. t’ia paguaj shumën prej 644.80 euro, në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 20.07.2017, ka theksuar se të paditurit kanë kontrabanduar mallra nga Suedia në Republikën e Kosovës, përkatësisht kanë futur mallin në vlerë prej 11,054.00 euro, me çka nuk i kanë paguar taksat doganore të detyrueshme prej 3,318.05 euro. Tutje përmes padisë, ka shtuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, pastaj edhe Gjykata e Apelit, të paditurit i kanë shpallur fajtor dhe gjykuar, të paditurin e parë me dënim unik prej 10 muajve burgim, ndërsa të paditurin e dytë dhe të tretë me dënim prej 9 muajve burgim, ndërsa pala e dëmtuar, D.K. është udhëzuar në kontest civil. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, i padituri i parë I.D. me rastin e importimit të mallit nga shteti i Suedisë në Kosovë, nuk ka respektuar procedurën doganore, nuk ka plotësuar formularin – procesverbalin e deklarimit të mallit për udhëtarët, si dhe dy oficerët doganor këtu i padituri i dytë dhe i padituri i tretë në cilësi të zyrtarëve doganor i kanë mundësuar kalimin e mallit pa i paguar taksat doganore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar përmes padisë, mirëpo të njëjtat nuk i ka specifikuar.

Në raport me padinë e paditëses, i padituri i parë I.D. përveç se e ka kontestuar padinë, në seancën përgatitore ka paraqitur kundërpadi, përmes së cilës ka deklaruar se D.K. pa bërë analizën e provave të cilat gjinden në shkresat e çështjes ka kërkuar kompensimin e dëmit kinse i padituri me të paditurit tjerë Xh.L. dhe L.H. kanë kontrabanduar mallra nga Suedia në Republikën e Kosovës, përkatësisht kanë futur mallin në vlerë prej 11,054.00 euro me çka nuk i kanë paguar taksat doganore të detyrueshme prej 3,318.05euro. Ka shtuar se, aktgjykimet të cilat bëhet fjalë në padinë e theksuar nga ana e D.K. Aktgjykimi PKR.nr.191/16 dt.02.12.2016 dhe Aktgjykimit PAKR.nr. 154/17 i datës 08.06.2017 janë anuluar nga Gjykata Supreme e Kosovës sipas Aktgjykimit PML. Nr. 232/2017 i datës 10.04.2018. Ndërsa, me rastin e rigjykimin të paditurve me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.Nr.99/2018, të paditurit Xh.L. dhe L.H. janë liruar nga akuza për veprën penale Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragraf 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse për të paditurin I.D. konform nenit 363 paragraf 1 nën-paragraf 1.3 të KPPK-së, refuzohet akuza e ngritur nga ana e Prokurorisë për shkak të veprave penale Kontrabandim i mallrave nga neni 317 paragraf 1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave doganore nga neni 318 par 1 të KPRK-së. Tutje, ka shtuar se nuk mund të konsiderohet kontrabandim i mallrave e as shmangie nga detyrimet doganore, kur në rastin konkret me mallin për të cilin behët fjalë në padi i padituri ka hyrë në mënyrë legale në kufi, është bërë kontrollimi i mallit në mënyrë legale nga zyrtarët doganor ku është konstatuar se bëhet fjalë për mallra të vjetra të dedikuara nga bashkatdhetarët për familjet e tyre, për çka nga zyrtaret doganor është liruar nga detyrimet doganore, e vetmja rrethanë ka qenë pse nuk është lëshuar një vërtetim mbi lirimimin nga dogana, mirëpo edhe ajo çështje është sqaruar për faktin se në atë kohë nga dogana nuk është kërkuar një vërtetim i tillë të lëshohet. Nga gjykata ka kërkuar që të refuzohet në tërësi e pa bazuar kërkesëpadija e paditëses - kundër të paditurës D.K., të aprovohet në tërësi e bazuar kërkesa sipas kundërpadisë së të paditurit kundërpaditësit I.D., ashtu që të detyrohet paditësja e kundër paditura D.K. që në emër të kompensimit për automjetet e konfiskuara dhe atë: kombi Mercedes Benz sprinter me targa të regjistrimit TCC 680, Mercedes Benz vito 115 CDI 2.9 t me targa të regjistrimi DAA dhe automjeti Volkswagen

Caddy skabil 1.9 TDI me targa të regjistrimit OMO 247 në shumën prej 15,812.72 euro dhe në emër të mallit në konfiskuar shumën prej 11,054,90 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, me kamat ligjore nga dita e nxjerrjes se ekspertizës e deri në përmbushjen e tërësishme.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë në emër të përpilimit të kundërpadisë në shumën prej 320.00 euro, për shpenzime të ekspertizës shumën prej 150.00 euro, për pesë seanca shumën prej 416.00 euro për secilën seancë, në shumën prej 2,080.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 2,550.00 euro.

I padituri i dytë Xh.L. përmes përgjigjes në padi, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Pml. Nr. 232/2017 datë 10.04.2018, miraton kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, i anulon pjesët dënuese të aktgjykimeve të lartpërmendura dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore për rivendosje. Gjykata Themelore me Aktgjykimin PKR. nr. 99/2018 datë 31.05.2022 më liron nga akuza. Kundër këtij Aktgjykimi, Prokurori i Shtetit ka bërë ankesë pranë Gjykatës së Apelit me datë 15.06.2022, e cila me anë të Aktgjykimit PAKR. nr. 376/2022 datë 30.08.2022, e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 99/2018 datë 31.05.2022 dhe Aktgjykimi mbi lirimimin behët i plotfuqishëm, andaj bazuar në këtë gjykatës i ka propozuar që padinë e paditëses të hedh poshtë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri i tretë L.H. përmes përgjigjes në padi, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, gjatë administrimit të provave nga ana e gjykatës është vërtetuar se kësaj padie i mungon baza ligjore, pasi që tani e kemi aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës, me të cilin aktgjykim i padituri i tretë është liruar nga të gjitha pikat e aktakuzës, Aktgjykimi PKR.nr.99/2018 i plotfuqishëm i datës 31.05.2022, i cili aktgjykim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit me numër PAKR.nr.376/2022, dt.30.08.2022. Ka shtuar se, në seancën e datës 21.03.2024, paditësja akoma ka qëndruar prapa padisë duke mos ndryshuar padinë, edhe pse gjendja reale ka ndryshuar, dhe atë për faktin se baza e kërkesëpadisë ka qenë e mbështetur mbi aktgjykimet të cilat janë anuluar nga Gjykata Supreme, dhe tani më është marrë aktgjykimi lirues PKR.nr.99/2018 i plotfuqishëm i datës 31.05.2022, i cili aktgjykim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit me numër PAKR.nr.376/2022, i datës 30.08.2022. Tutje, ka shtuar se nga interpretimi i dispozitave ligjore mund të konstatojmë se, faktet e treguara në padi kanë vërtetuar se paditësja D.K. , ka parashtruar padinë mbi bazën e aktgjykimeve të anuluar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, pra i mungon themelësia e padisë, për çështjen që kërkon të gjykohet nuk ka bazë ligjore dhe del në pah parimi “*nullum crimen, nulla poena sine lege.*” Ka theksuar se, të gjitha konstatimet e cekura nga paditësja janë në kundërshtim me gjendjen faktike, pasi i padituri L.H. në procedurën penale është liruar nga të gjitha pikat e aktakuzës, pasi që nuk ka pasur elemente të veprës penale, ku në procedurën penale është vërtetuar se ai mall nuk ka qenë mall komercial dhe nuk duhet ti nënshtrohet procedurave doganore, pasi që janë gjësende të përdorura, dhe krejt kjo është vërtetuar nga ekspertizat e detajuara në procedurën penale. Po ashtu, ka shtuar se në mungesë të elementeve të ndonjë veprë penale, nuk mund të ketë as shkelje disiplinore, sepse këto shkelje të pretenduara kanë filluar mbi bazën e aktakuzës, e që kjo aktakuzë ka rezultuar me refuzim të saj dhe vërtetim të gjendjes faktike që malli nuk është për

tu doganuar. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumë prej 208.00 euro, për secilin përfaqësim në pesë seanca nga 135.20 euro në shumë prej 676,00 euro, gjithsejtë në shumë prej 884.00 euro, e të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në ditën e pagesës përfundimtare me kërkesë të përmbartimit të dhunshëm.

Në raport me kundërpadinë e të paditurit – kundërpaditësit, paditësja e kundërpaditura D.K. përmes përgjigjes në kundërpadi dhe në seancat e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, e kundërshtojmë në tërësi kundërpadinë e të paditurit I.D. dhe i propozojmë gjykatës që të njëjtën të refuzoj në tërësi si të pa bazuar, kundërpaditësi me asnjë provë relevante juridike nuk ka paraqitur në kundërpadi dhe kërkesa e padisë së tij për kompensim dëmi është në tërësi e pa bazuar. Ka shtuar se, pretendimi i kundërpaditësit se është refuzuar akuza në procedurë penale për vepër penale kontrabanim të mallrave nga neni 317 i KPK-së lidhur me nenin 318 për shmangie të pagesave të tarifave doganore dhe mbi këtë bazë konsideron se dogana ka shkaktuar dëm është i pa qëndrueshëm, refuzimi i aktakuzës në procedurë penale ndaj I.D. nuk nënkupton se i njëjti nuk i ka shkaktuar dëm D.K., andaj edhe mos vërtetimi i kryerjes se veprës penale dhe përgjegjësisë penale nuk do të thotë se nuk ekziston përgjegjësia civile për kompensim dëmi ndaj D.K. Ka theksuar se, sipas dispozitave të nenit 14 të LPK-së pretendimi i kundërpaditësit është pa bazë juridike sepse gjykata civile nuk mund të bëjë të varur kërkesëpadinë e D.K. nga epilogu i procedurës penale, e të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, sipas dispozitës së lartë përmendur në procedurën kontestimore gjykata nga pikëpamja e ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale është e lidhur me aktgjykim të formës se prerë dhe me atë që i pandehuri është shpallur fajtor. Tutje ka theksuar se, pretendimi i kundërpaditësit se malli me tre automjete (kombi) ka hyrë në mënyrë legale në Kosovë duke theksuar në kundërpadi vlerën e mallit në lartësi prej 11.054.00 dhe duke kërkuar edhe vlerën për tre automjete në shumë prej 16.400.00 euro janë deklarime të paditësit kontradiktore. Ka shtuar se, është e habitshme se vet kundërpaditësi e kërkon shumë prej 11.054.00 euro, ndërsa për këtë shumë nuk ka paguar taksa doganore e as që ka pasur bazë juridike për lirim të mallit. Andaj, me këtë deklaram të vet paditësit në kundërpadi qartë nënkuptohet se kundërpaditësi e ka futur mallin në Kosovë pa i paguar taksat doganore. Ka deklaruar se, kundërpaditësi nuk ka asnjë provë (dokument unik doganor) se ka paguar taksat ose ndonjë akt tjetër se është liruar nga taksa doganore, pra kundërpaditësi vet e konfirmon se malli në lartësi prej 11.054.00 euro nuk i ka paguar detyrimet doganore. Tutje ka theksuar se, sipas dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës neni 47 kreu XI *“lirimet lejohen deri në shumë 175 euro për udhëtarë, me kusht që edhe ky mall në këtë lartësi nuk është mall i natyrës komerciale.”* Ka shtuar se, llojet e automjeteve që kundërpaditësi kërkon shumë prej 16.400.00 euro siç janë Cady, Mercedes Benz dhe kombi Mercedes gjenden në parkingun e automjeteve të D.K., ndërsa malli i ndaluar një pjesë e tij është dhënë donacion sipas vendimit të Komisionit Shtetëror të Ministrisë së Financave nr. 01/2021 datë 28.01.2021, ndërsa pjesa tjetër është shitur në ankandin nr.04.2022 për çka gjykatës dhe palëve ja dorëzoi parashtresën me provë/shkresë nga sektori i logjistikes dhe dokumenti unik doganor. Andaj, nga vet deklaramet e kundërpaditësit i cili kërkon vlerën e mallit prej 11.054.00

euro është e pakuptimtë kjo kërkesë sepse siç theksuam me lartë nuk ka asnjë baze juridike që t'i kthehet malli. Tutje, ka shtuar se pasi që procedura penale ka filluar sipas aktakuzës së prokurorit, vendimet e mëhershme të paditurit janë shpallur fajtor dhe është konfiskuar malli, dhe nuk është ndërmarrë asnjë procedurë tjetër në raport me mallin e konfiskuar për shkak se është pritur epilogu i procedurës penale. Kurse në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, refuzimi i aktakuzës në procedurë penale ndaj I.D., nuk nënkupton se i njëjti nuk i ka shkaktuar dëm D.K., andaj dhe mos vërtetimi i kryerjes se veprës penale dhe përgjegjëses penale të kundërpaditësit, nuk do të thotë se nuk ekziston përgjegjësia civile për kompensimin e dëmit ndaj D.K. Ka theksuar se, pa mëdyshje konstatohet se ndaj të paditurve është zhvilluar dhe udhëhequr procedurë penale, dhe jo administrative dhe nga kjo gjendje faktike rrjedh se të paditurit kundërpaditësit ndaj D.K. i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje civilo-juridike. Ndërsa, tutje ka shtuar se kërkesëpadia e kundërpaditësit ndaj D.K. sipas dispozitave të LMD-së eshë e parashkruar në afatin kohor, sepse rasti ka ndodhur me datë 01.03.2016 kur është ndaluar malli, ndërsa kundërpaditësi ka parashtruar kundërpadi me datë 27.02.2024 më shumë se 8 vite, sipas dispozitës së nenit 357 të Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, gjykata ka administruar provat si në vijim: Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër PAKR .nr. 154/17 i datës 08.06.2017, Aktgjykimi i GJTHP me numër PKR nr. 191/16 i datës 02.12.2016, Aktgjykimi i GJTHP me numër PKR nr. 99/18 i datës 31.05.2022, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PML nr.232/17 i datës 10.04.2018, Procesverbali i deklaramit të mallit për udhëtar, Rekomandimi me nr. 245 i datës 04.08.2016, Rekomandimi me nr.307 i datës 23.09.2016, Vendimi me nr. 378 i datës 03.10.2016, Kallëzimi penal me nr. H-06/2016 i datës 03.03.2016, Komunikimi përmes e-mailit i datës 21.02.2024 si dhe komunikimi i datës 01.12.2018 se bashku me dudin doganor të datës 06.04.2022, Faturat të lëshuara në emër të I.D. me datë 11.02.2016 dhe me datë 27.09.2012, Aktgjykimi i GJTHP me nr. C.nr. 110/17 i datës 19.03.2024, Kërkesat e datës 22.01.2018 dhe datës 14.11.2022, Ekspertiza financiare e datës 06.05.2024, Aktvendimi i datës 29.07.2010 dhe aktvendimi i datës 31.08.2010.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e refuzoj në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses – të kundërpaditurës D.K. duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa e aprovoj në tërësi të bazuar kundërpadinë e të paditurit – kundërpaditësit I.D. .

Nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara rezulton se nuk ishte kontestuese në mes të palëve se ndaj të paditurit kundërpaditësit I.D., të paditurit të dytë Xh.L. dhe të paditurit të tretë L.H. është iniciuar dhe zhvilluar procedurë penale lidhur me dyshimin për kryerjen e veprës penale kontrabandimi i mallrave, përkatësisht veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Po ashtu, nuk ishte kontestuese në mes të palëve se i padituri - kundërpaditësi I.D. , i padituri i dytë Xh.L. dhe i padituri i tretë L.H. janë liruar nga përgjegjësia penale, fakt që konstatohet edhe nga aktgjykimi penal në shkresa të lëndës. Njëkohësisht, nuk ishte kontestuese në mes të palëve se nga paditësja e kundërpaditura D.K., nuk është zhvilluar ndonjë procedurë

tjetër administrative. Nuk ishte kontestuese se malli i ndaluar nga paditësja e kundërpaditura D.K. është shitur në ankand publik dhe një pjesë e tij është dhënë donacion dhe vlera e të njëjtit ka qenë në lartësi prej 11,054.90 euro, e po ashtu nuk ishte kontestuese se automjetet fillimisht janë ndaluar nga D.K. dhe të njëjtat gjenden në parkingun e D.K. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se mallrat e ndaluara dhe automjetet kanë qenë në zotërim të paditurit – kundërpaditësit I.D. .

Mirëpo, nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike kontestimore, si çështje kontestuese paraqitet baza e kërkesëpadisë, lidhur me atë nëse të paditurit i kanë shkaktuar dëm material paditëses, dhe atë sipas pretendimit të paditëses se i padituri - kundërpaditësi ka kontrabanduar mallra nga Suedia duke ju shmangur obligimeve doganore i ndihmuar nga i padituri i dytë dhe i tretë në cilësi të zyrtarëve doganor. Ndërsa, njëkohësisht edhe kërkesa sipas kundërpadisë së të paditurit - kundërpaditësit I.D. për paditësen të kundërpaditurën D.K., ishte kontestuese baza juridike e kundërpadisë.

Nga kallëzimi penal me numër të lëndës H-06/2016 i paraqitur me datë 03.03.2016 nga Njësi kundër Krimet të Organizuar – Sektori i Hetuesisë Doganore në kuadër të D.K. për Prokurorinë Themelore në Prishtinë, gjykata konstatoj se këtu paditësja e kundërpaditura kishte paraqitur kallëzim penal ndaj të paditurit - kundërpaditësit I.D. lidhur me dyshimin për kryerjen e veprës penale Kontrabandim i mallit dhe Dhënia e ryshfetit, dhe ndaj të paditurit të dytë Xh.L. dhe të paditurit të tretë L.H. lidhur me dyshimin për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe Marrja e ryshfetit.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me numër PKR. nr. 99/2018 i plotfuqishëm nga data 30.08.2022, gjykata konstatoj se ndaj të paditurit të parë kundërpaditësit I.D. është refuzuar akuza, ndërsa i padituri i dytë Xh.L. dhe i padituri i tretë L.H. janë liruar nga akuza.

Nga ekspertiza financiare e datës 06.05.2024 gjykata konstatoj se vlera e blerjes së automjeteve sipas faturave të shndërruara sipas kursit të valutës nga kruna në euro, në kohën e blerjes së automjeteve është 15,812.72 euro, ndërsa vlera e mallrave të vlerësuara nga D.K. ka qenë 11,054.90 euro. Nga kjo ekspertizë gjykata i vlerësoj dhe analizoj edhe provat e bashkëngjitura, dhe atë: Mendimet për vlerësimin e mallit sipas kërkesës HG – 06/2016 të datës 03.03.2016, 01.03.2016, email-i i datës 21.02.2024 në mes të zyrtarëve të paditëses – të kundërpaditurës, Raporti mbi rastin i datës 01.03.2016 nga B.Rr., aneksi i lëndës – VNKM 000629, aneksi me numër 001297 i datës 01.03.2016, aneksi me numër 00198 i datës 01.03.2016, vërtetimi mbi ndalimin/konfiskimin e mallrave me numër 000629/2011, vërtetimi mbi ndalimin/konfiskimin e mallrave me numër 001302/2011 nga L.B., fatura me numër 91 e datës 27.09.2012 dhe fatura me numër 92 e datës 11.02.2016.

Nga Mendimet për vlerësimin e mallit sipas kërkesës HG – 06/2016 të datës 03.03.2016, 01.03.2016, gjykata konstatoj se nga kalkulimi i secilit vlerësim sipas vlerësimeve të ndara në shumën prej 3726.50 euro, 1,311.40 euro, 88.00 euro dhe 5,929.00 euro, rezulton shuma e përgjithshme në lartësi prej 11,054.99 euro, vlerësim ky i kryer nga paditësja – e kundërpaditura D.K. .

Nga email-i i datës 21.02.2024 në mes të zyrtarëve të paditëses – të kundërpaditurës D.K., gjykata konstatoj se zyrtari F.P. nga Njësiti i Mallrave të Konfiskuara i konfirmon zyrtarit Xh.K. se automjeti Caddy gjendet në parkingun e automjeteve të Doganës në Ajvali, ndërsa malli është shitur në ankandin 04/2022 shkarkuar me DUD IM4 R-343/2022, automjeti mercedes benz 115 gjendet në parkingun e doganës në Ajvali, ndërsa malli është shitur në ankandin 04/2022 shkarkuar me DUD IM4 R-343/2022, kurse automjeti kombi mercedes 316 gjendet në parkingun e doganës në Ajvali, një pjesë e mallit është dhënë donacion sipas Vendimit të Komisionit Shtetëror të Ministrisë së Financave me nr. 01/2021 i datës 28.01.2021, ndërsa një pjesë nga malli është shitur në Ankandin 04/2022 shkarkuar me DUD IM4 R-343/2022.

Nga Raporti mbi rastin i datës 01.03.2016 nga Bekim Rrahmani, aneksi i lëndës – VNKM 000629, aneksi me numër 001297 i datës 01.03.2016 dhe aneksi me numër 00198 i datës 01.03.2016, gjykata konstatoj se në të njëjtit janë të përshkruara në formë të listës mallra të ndryshme të ndaluara dhe se të njëjtat mallra janë të përdorura, duke filluar nga testues i baterive, mbrehës të burgive, mbushës të baterive, çekan për bulona, sharr metali, sharr druri, etj, sipas listës në këto anekse. Po ashtu, në të njëjtat anekse është e shënuar se *“mallrat e poshtëshënuar do të jenë nën mbikëqyrjen doganore deri në përfundimin e procedurës”*, anekse këto ku në njërin prej tyre në cilësi të kundërvajtësit është nënshkruar Q.B., kurse në dy të tjera në të njëjtën cilësi është nënshkruar I.D. .

Nga vërtetimi mbi ndalimin/konfiskimin e mallrave me numër 000629/2011 dhe vërtetimi mbi ndalimin/konfiskimin e mallrave me numër 001302/2011, gjykata konstatoj se në të njëjtit janë lëshuar nga Departamenti Anti Kontrabandë i D.K., dhe në të njëjtit është e shënuar se mallrat janë të ndaluara/konfiskuara përkohësisht, dhe se personi përgjegjës për të mësuar për statusin e mallit duhet të paraqitet në Doganën e Kosovës, Departamenti Anti Kontrabandë, në afat prej 30 ditëve duke filluar nga dita e ndaljes së mallit. Tutje, në të njëjtit vërtetime është e shënuar se, *“në qoftë se mallrat e ndaluara do të konfiskohen atëherë ju do të njoftoheni me shkrim mbi këtë vendim duke përfshirë edhe informacionin për procedurat e ankimimit, këtë ju duhet të bëni me shkrim në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit siç kërkohet me paragrafin 2 të nenit 291 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.”* Vërtetimet janë të lëshuara në emër të I.D. dhe Qaush Blakaj.

Nga fatura me numër 91 e datës 11.02.2016, gjykata konstatoj se në cilësi të blerësit ishte I.D. për dy automjete dhe atë Mercedes Benz Vito 115 CDI 2.9t me targa të regjistrimit DAA622 dhe automjeti Volkswagen Caddy skabil 1.9 TDI me targa të regjistrimit OMO 247, dhe të njëjtat vetura shitën për eksport. Ndërsa nga fatura me numër 92 e datës 27.09.2012 gjykata konstatoj se në cilësi të blerësit është I.D. për automjetin Mercedes Benz Sprinter 316 CDI mini bus me targa të regjistrimit TCC680, dhe se i njëjti automjet shitet për eksport.

Nga provat e administruara dhe vlerësuara sikurse me lartë, gjykata konstatoj gjendjen faktike dhe atë se paditësja e kundërpaditura D.K. kishte ndaluar përkohësisht mallrat në vlerë prej 11,054.99 euro dhe automjetet Mercedes Benz sprinter me targa të regjistrimit TCC 680, Mercedes Benz vito 115 CDI 2.9t me targa të regjistrimi DAA dhe automjetin Volkswagen Caddy

skabil 1.9 TDI me targa të regjistrimit OMO 247, të cilat mallra dhe automjete ishin në zotërim të paditurit - kundërpaditësit I.D. . Ndalimi i këtyre mallrave dhe automjeteve nga D.K. ishte bërë nën dyshimin se malli ishte i kontrbanduar dhe se i njëjti ka qenë duke u bartur nga automjetet e ndaluara. Gjykata konstatoj se ndaj të paditurve është zhvilluar procedurë penale, dhe se të njëjtit janë liruar nga përgjegjësia penale. Po ashtu, gjykata konstatoj se paditësja e kundërpaditura nuk ka zhvilluar asnjë procedurë, e as nuk ka nxjerr ndonjë vendim lidhur me mallrat dhe automjetet e ndaluara. Njëkohësisht, gjykata konstatoj se një pjesë e mallrave është shitur, ndërsa pjesa tjetër është dhënë donacion, kurse automjetet gjenden në parkingun e D.K.

Meqenëse, në rastin konkret pretendim i paditëses të kundërpaditurës D.K. dhe i të paditurit – kundërpaditësit I.D. sipas kundërpadisë është kompensimi i dëmit, gjykata vlerëson së në këtë çështje juridike civile duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili në nenin 136 paragraf 1 parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Ndërsa, në raport me përkufizimin e dëmit me nenin 137 të këtij Ligji përcaktohet se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”* Kurse, me nenin 140 të këtij Ligji parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkakuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Ndërsa me tutje, me Kodin Nr. 03/l-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur pretendohet se ka ndodhur kontrabandimi i mallrave, me nenin 273 paragraf 1 parashihet se: *“Shkeljet në fushën doganore nënkuptojnë Kundërvajtjet administrative doganore dhe veprat penale.”* Kurse, me të njëjtin Kod, përkatësisht me kapitullin 2 të tij janë paraparë kundërvajtjet administrative doganore, ku në nenin 276 paragraf 1 pika a) përcaktohet se: *“Personi juridik apo fizik: a). Në qoftë se, nuk e paraqet mallin:”* duke nënkuptuar se i njëjti kryen shkelje doganore. Me tutje, me nenin 279 parashihet procedura e rregullt administrative, sipas të cilit: *“1. Çdo shkelje administrative tjetër, të parapara me nenin 279, do të jenë objekt i procedurës së rregullt, e cila do t’i iniciohet prej Doganës, ku është bërë shkelja administrative me procesverbal zyrtar. 2. Procedura zhvillohet pranë Sektorit për kundërvajtje doganore në Doganë, vendimi do të merret sipas nenit 12 të këtij Kodi”* Kurse, në raport me mallin e ndaluar me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 284 të këtij Kodi përcaktohet: *“1. Malli i cili është objekt i konfiskimit sipas dispozitave tjera në fuqi, mund të ndalet deri në përfundimin e asaj procedure përkatëse. 2. Malli që është objekt i shkeljes administrative doganore, për të cilin është parapare konfiskimi i mallit, do të ndalet deri në përfundimin e procedurës kundërvajtëse.”* E po ashtu, me nenin 288 paragraf 1 përcaktohet se: *“Malli i konfiskuar në procedurën e shkeljes administrative doganore dhe malli, të cilin Dogana e ka konfiskuar sipas dispozitave tjera të këtij Kodi, do t’i nënshtrohet shitjes.”* Kurse, me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje Konventa), e cila parasheh mbrojtjen e pronës, sipas së cilës: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”*

Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të plotësohen disa kushte, dhe atë fillimisht duhet të shkaktohet dëmi, pastaj duhet të ekzistojë veprimi i kundërligjshëm, të ekzistojë lidhja kauzale në mes të shkakut dhe pasojës, si dhe të ekzistojë fajësia.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës gjykata nuk ka arritur të konstatoj përgjegjësinë e të paditurit – kundërpaditësit I.D. , të paditurit të dytë Xh.L. dhe të paditurit të tretë L.H., të cilët nëse me veprimet e tyre të kundërligjshme kanë shkaktuar pasojën apo dëmin të cilin e pretendon paditësja – e kundërpaditura D.K. Kjo për faktin se, paditësja e kundërpaditura D.K., në këtë procedurë nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme, për t’i mbështetur pretendimet e saja në raport me të paditurit, përveç aktgjykimeve të nxjerra në procedurë penale. Mirëpo, lidhur me këtë, gjykata konstatoj se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me numër PKR.nr.99/2018 i plotfuqishëm nga data 30.08.2022, ndaj të paditurit të parë kundër paditësit I.D. është refuzuar akuza, ndërsa i padituri i dytë Xh.L. dhe i padituri i tretë L.H. janë liruar nga akuza, dhe i njëjti në aspektin juridik nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe gjykata në procedurën kontestimore nuk është e lidhur me të dhe as me gjendjen faktike të vërtetuar nga ky aktgjykim. Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”* mirëpo, në këtë rast aktgjykimi i prezantuar si provë, është anuluar dhe nuk i plotëson kushtet të cilat kërkohen me nenin 14 të LPK-së.

Gjykata vlerësoj se paditësja e kundërpaditura D.K., nuk ka arritur t’i argumentoj pretendimet e saja të deklaruara në seancën e shqyrtimit kryesor sipas së cilës i padituri i parë I.D. me rastin e importimit të mallit nga shteti i Suedisë në Kosovë nuk ka respektuar procedurat doganore, nuk ka plotësuar formularin - procesverbalin e deklarimit të mallit për udhëtarët, si dhe dy oficeret tjerë Xh.L. dhe L.H. zyrtar doganor këtu i padituri i dytë dhe i tretë, i kanë mundësuar kalimin e mallit pa i paguar taksat doganore, duke shtuar se automjetet i ka ndaluar sektori i anti kontrabandës në afërsi të fshatit Leban, ndërsa malli ka kaluar nga pika doganore Merdarë pa i paguar taksat doganore, ku në cilësi të provës gjykatës i ka dorëzuar një kopje të procesverbalit për deklarimin e mallit për udhëtar. Në lidhshmëri me këtë, gjykata e vlerësoj të njëjtin procesverbal i paraqitur në cilësi të provës, dhe konstatoj se njëjti nuk përmban ndonjë të dhënë në raport me palët ndërgjyqëse, përveç rubrikave me të dhëna të cilat duhet të plotësohen, mirëpo përmes këtij procesverbali nuk mund të konstatohet ndonjë fakt, në mungesë të provave të tjera. Për më shumë, një pretendimi i tillë i paditëses të kundërpaditurës ngërthen në vete elemente penale, dhe në raport me të njëjtat pretendime, të paditurit janë liruar nga përgjegjësia penale. Bazuar në të lartcekurat, e duke marr për bazë faktin se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, e në përputhje me nenin 7 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton rolin aktiv të të dyja palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor, sipas të cilit: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e po ashtu, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 319 të LPK-së, sipas të cilit: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.”*, gjykata vendosi sikurse në pikën I

të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që konstatoj se kërkesës së paditëses të kundërpaditurës D.K. i mungon baza ligjore e kërkesëpadisë.

Kurse, në raport me kundërpadinë e të paditurit – kundërpaditësit I.D., gjykata konstatoj se paditësja e kundërpaditura D.K. në mungesë të vendimit penal dënues, nuk i ka ndërmarr veprimet administrative apo kundërvajtëse të përcaktuara me Kodin Nr. 03/1-109 Doganor dhe i Akcizave, dhe rrjedhimisht pa asnjë bazë ligjore ka vazhduar të mbaj të ndaluara automjetet dhe njëkohësisht të njëjtat nuk i ka kthyer të paditurit – kundërpaditësit, duke i shkaktuar të njëjtit dëm material. Paditësja e kundërpaditura D.K., nuk ka vepruar sipas nenit 273 paragraf 1 të Kodit Doganor, pasi që e njëjta paraprakisht ka vlerësuar se i padituri kundërpaditësi ka kryer kundërvajtje administrative doganore, në cilësi të personit fizik, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 paragraf 1 të këtij Kodi. Me tutje, paditësja e kundërpaditura D.K., nuk ka vepruar sipas nenit 279 të Kodit Doganor, i cili ka përcaktuar procedurën e rregullt administrative, e cila duhet të iniciohet nga paditësja e kundërpaditura, përkatësisht Sektori për Kundërvajtje Doganore. Paditësja e kundërpaditura D.K., duke vepruar në këtë mënyrë, në mungesë të zhvillimit të procedurës kundërvajtëse administrative, nuk e ka liruar mallin e ndaluar, ashtu siç parashihet me nenin 284 paragraf 1 të Kodit Doganor të Akcizave. Në mungesë të aktgjykimit dënues penal, e po ashtu duke qenë se paditësja e kundërpaditura D.K. nuk ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse administrative në raport me mallrat e ndaluara dhe automjetet ashtu siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura të Kodit Doganor dhe i Akcizave, gjykatës i rezultojë se nga momenti kur Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me numër PKR. nr. 99/2018 është bërë i plotfuqishëm, dhe atë me datë 30.08.2022, ndalimi i mallrave dhe me tutje shitja e tyre nga paditësja e kundërpaditura dhe ndalimi i automjeteve është bërë pa asnjë bazë ligjore. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se, është krijuar lidhja kauzale në mes veprimeve të paditëses – të kundërpaditurës dhe dëmit të shkaktuar tek i padituri - kundërpaditësi, kjo për faktin se siç është arsyetuar me lartë, paditësja e kundërpaditura me mbajtjen për një kohë të gjatë të automjeteve të paditurit – kundërpaditësit pa bazë ligjore, të njëjtit i ka shkaktuar dëm material, kompensimi i të cilit derivon nga fakti se të paditurit – kundërpaditësit i është mohuar posedimi, mbajtja dhe/ose afarimi me të njëjtat automjete.

Bazuar në këtë gjendje të konstatuar, meqenëse paditësja e kundërpaditura nuk i ka ndërmarr veprimet e përcaktuara ligjore, dhe si pasojë e kësaj të paditurit kundërpaditësit i ka shkaktuar dëm, gjykata konstatoj se përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi paditësen të kundërpaditurën D.K. Në lidhshmëri me këtë, me nenin 169 paragraf 1 dhe 3 të LMD-së parashihet se: *“1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”* Mbi bazën e dispozitave të lartcekura, gjykata vlerësoj se rivendosja në gjendjen e mëparshme është e pamundur, kjo për faktin se paditësja e kundërpaditura ka bërë shitjen e një pjese të mallrave të ndaluara, ndërsa një pjesë e ka dhënë donacion, kurse në raport me automjetet e njëjta i mban të ndaluara pa bazë ligjore, kjo për faktin se nga paditësja e kundërpaditura është pohuar në procedurë gjyqësore që nuk ka nxjerr vendim për mbajtjen e automjeteve të ndaluara, gjegjësisht nuk ka krijuar asnjë baze ligjore mbi të cilën do të arsyetohej mbajtja e automjeteve

te të paditurit - kundërpaditësit dhe njëkohësisht i padituri kundërpaditësi është i privuar nga e drejta e posedimit të tyre për një kohë të gjatë. Po ashtu, paditësja e kundërpaditura në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se i padituri – kundërpaditësi nuk ka asnjë bazë që t'i kthehet malli, duke mos shprehur gatishmëri për kthimin e të njëjtit. Bazuar në këtë fakt, duke marrë për bazë edhe faktin se gjykata është e lidhur me kërkesën e palës në procedurë, gjykata vlerëson se ndonëse nga paditësi nuk është kërkuar kthimi i automjeteve, një rrethanë e tillë nuk ka për pasojë mohimin e të drejtës së të paditurit – kundërpaditësit për të kërkuar kompensimin e vlerës së automjeteve të ndaluara, marrë për bazë kohën e gjatë që ka kaluar nga koha e ndalimit të automjeteve. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se të paditurit - kundërpaditësit duhet t'i ofrohet mbrojtje gjyqësore, e duke qëndruar brenda kërkesës së tij, ashtu siç parashihet me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”* vendosi që shpërblimi i dëmit pasuror të bëhet me pagesën e shumës së caktuar të parave, sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me tutje sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje GJEDNj), e cila në rastin *Tendam v. Espania* Nr. 25720/05, kishte konstatuar se, pas shpalljes së pafajësisë së kërkuarit dhe lirimit nga akuzat penale, ku disa nga sendet paraprakisht të sekuestruara ishin dëmtuar, gjykatat vendase që shqyrtuan ankesën e ankuesit nuk kishin marrë parasysh përgjegjësinë e administrimit të drejtësisë në faktet e çështjes dhe as nuk e kishin lejuar kërkuarin të merrte kompensim për dëmin që rezulton nga mos ruajtja e pasurisë së sekuestruar, duke konstatuar se autoritetet vendase që kanë refuzuar kompensimin e kërkuar nga kërkuari i kanë vënë kërkuarin një barrë joproporcionale dhe të tepruar, ku për rrjedhojë, kishte konstatuar shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës. Ndërsa, GJEDNj në rastin tjetër *Jucys v. Lithuania* Nr. 5457/03, ku paraqitësi i kërkesës ishte arrestuar duke kaluar kufirin, pasi që i njëjti dyshohej për kontrabandim të mallrave, dhe njëkohësisht i ishin konfiskuar të njëjtat mallra, të cilat më pastaj ishin vendosur në ankand dhe ishin shitur. Kërkuari ishte shpallur i pafajshëm, dhe ishte liruar nga akuzat penale. Në këtë rast, GJEDNj kishte konstatuar se, për të qenë në përputhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, dëmi aktual i pësuar nuk duhet të jetë më i gjerë se ai që është i pashmangshëm, duke vlerësuar se pronari “i pafajshëm” i mallrave kontrabandë në parim duhet të ketë të drejtë të rikuperojë sendet e konfiskuara. Tutje, GJEDNj kishte vlerësuar se, pas lirimit nga akuzat penale, ankuesi ishte në gjendje të kërkonte të ardhurat aktuale të ankandit. Megjithatë, gjykatave iu deshën më shumë se tetë vjet e gjysmë për ta zgjidhur këtë çështje, edhe pse ajo nuk kishte asnjë kompleksitet. GJEDNj në këtë rast, thekson se faktet ishin përcaktuar tashmë në procedurë penale të mëparshme kundër ankuesit. Në vend të kësaj, disa vite të këtyre proceseve civile u morën me përpjekjet e gjykatave vendase për të përcaktuar çështjen e juridiksionit. Rrjedhimisht, pasi iu nënshtroa tendosjeve të një ndjekjeje penale të pabazuar, dhe pasi kishte humbur kontrollin e zotërimeve të tij të cilat u nxorën me ngut në ankand si mallra që prisheshin, kërkuari më pas u përjashtua nga të paktën kompensimi i pasurive. Duke pasur parasysh faktorët e mësipërm dhe në veçanti zvarritjen e procesit, GJEDNj kishte arritur në përfundimin se kërkuari i është dashur të mbajë një barrë joproporcionale dhe të tepruar në rrethanat e çështjes në fjalë, duke konstatuar se kishte shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

Gjykata mbi bazën e të lartcekurave, duke konstatuar gjendjen faktike e në përputhje me dispozitat ligjore nga e drejta materiale, vendosi të detyroj paditësen të kundërpaditurën D.K. të kompensoj dëmin e pësuar, në lartësinë sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Në raport me lartësinë e kërkesës së kundërpadisë, gjykata të njëjtën e konstatoj përmes ekspertizës financiare, e cila sipas vlerësimit të D.K. këtu paditëses të kundërpaditurës kishte konstatuar se vlera e mallrave është në lartësi prej 11,054.90 euro. Kurse, në raport me vlerën e automjeteve, eksperti kishte kalkuluar shumën mbi bazën e faturave të shndërruara sipas kursit të valutës nga krana në euro, dhe atë në lartësi prej 15,812.72 euro. Eksperti i kishte dhënë sqarimet e nevojshme në seancë gjyqësore, e po ashtu i ishte përgjigjur pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa të njëjtat shuma gjykata i vlerësoj si të bazuara për faktin se llogaritja e mallrave ishte bërë nga vet paditësja e kundërpaditura, ndërsa vlera për automjete ishte kalkuluar mbi bazën e faturave të dorëzuara nga i padituri kundërpaditësi, kurse paditësja në raport me këtë llogaritje, nuk kishte paraqitur propozime të reja.

Në të njëjtën kohë, gjykata i vlerësoj edhe pretendimet e paditëses të kundërpaditurës dhe atë lidhur me legjitimitetin pasiv, pasi që e njëjta pretendon se ndaj të paditurve është zhvilluar dhe udhëhequr procedurë penale, dhe jo administrative dhe nga kjo gjendje faktike rrjedh se të paditurit kundërpaditësit ndaj D.K. i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje civilo - juridike, mirëpo gjykata vlerësoj se një pretendim i tillë nuk qëndron. Nuk ishte kontestuese se ndalimi i mallrave dhe automjeteve ishte bërë nga D.K., nuk ishte kontestuese se shitja e mallrave është bërë nga D.K., e po ashtu nuk ishte kontestuese se D.K. i mban të ndaluara automjetet e të paditurit kundërpaditësit, andaj mbi këtë gjendje gjykata vlerëson se paditësja e kundërpaditura D.K. është e legjitimuar në këtë proces. Kurse, në raport me pretendimin e paditëses të kundërpaditurës D.K. së kërkesa sipas kundërpadisë është e parashkruar, sepse rasti ka ndodhur me datë 01.03.2016 kur është ndaluar malli, ndërsa kundërpaditësi ka parashtruar kundërpadi me datë 27.02.2024 pas më shumë se 8 vite, sipas dispozitës së nenit 357 të Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin, gjykata vlerësoj se një pretendim i tillë nuk qëndron. Kjo për faktin se, bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me numër PKR.nr.99/2018, përmes të cilit ishte refuzuar akuza në raport me të paditurin kundërpaditësin I.D., i njëjti ishte bërë i plotfuqishëm me datë 30.08.2022, dhe sipas vlerësimit të gjykatës, e drejta e kërkesës së të paditurit - kundërpaditësit ka lindur nga kjo datë, sepse deri në këtë fazë ka qenë duke u zhvilluar procedura penale, dhe me refuzimin e akuzës ndaj të njëjtit, është krijuar edhe e drejta për të paraqitur kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata i vlerësoj edhe provat dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, e cila përcakton se debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, ndërsa lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit. Si datë nga e cila rrjedh detyrimi i paditëses të kundërpaditurës për pagesën e kamatës, gjykata ka caktuar datën nga marrja e aktgjykimit me datë 27.11.2024.

Në raport me shpenzimet për të paditurin - kundërpaditësin I.D., gjykata vendosi që paditësja e kundërpaditura D.K. t'i bart shpenzimet e procedurës, dhe atë duke u bazuar në nenin 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e të paditurit - kundërpaditësit në këtë procedurë, shpenzimet i referohen përpilimit të kundërpadisë në shumën prej 208.00 euro, për shpenzime të ekspertizës shumën prej 150.00 euro, dhe për katër seanca shumën prej 270.40 euro për secilën seancë, e në shumën e përgjithshme prej 1,439.60 euro. Vendimin që paditësja D.K. t'i bart shpenzimet e procedurës në raport me të paditurin e tretë L.H. , gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 452 të LPK-së, sipas se cilës: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore.”* Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për pjesëmarrje në katër seanca gjyqësore shumën prej 135.20 euro për secilën seancë, si dhe për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 104.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 644.80 euro. Gjukata nuk i njohu shpenzimet e kërkuara në emër të seancës së pestë, për faktin se e njëjta ishte shtyrë pa fajin e paditëses – të kundërpaditurës D.K. .

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1806/2017, me datën 27.11.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.